

### 3. Riintegrimi dhe sistemi i referimit për shtetasit shqiptar të kthyer nga emigrimi.

Ky material vë në dispozicion informacion mbi shërbimet publike dhe private ekzistuese për të gjithë shtetasit shqiptarë, të zbatuara nga qeveria qendrore dhe vendore, në funksion të nevojave që ata kanë për marrjen e informacionit, si dhe hapat e procedurës për të përfituar nga këto shërbime online në portalin e-Albania [www.e-Albania.al](http://www.e-Albania.al)

<b>1. Aplikimi për strehimin social</b>	<p>Ligji për “<i>strehimin social</i>” rregullon kriteret, kushtet dhe procedurat për të siguruar strehimin, subvencionimin e qirasë ose strehimin e përkohshëm, mes kategorive të tjera të pambrojtura, migrantëve shqiptarë të kthyer, viktimave të trafikimit, shtetasve të huaj me një qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin e “Punëtorit migrant” dhe / ose “azilkërkuesit”.</p> <p>Bashkitë shpërndajnë programe të strehimit social si: Strehim social për qira; Qira e ulët; Bonus strehimi; Pajisje e tokës me infrastrukturën e nevojshme si kur është pronë private ashtu edhe kur është pronë publike.</p> <p>Për informacion më të detajuar ju lutem vizitoni faqen Bashkia Shkodër <a href="https://bashkiashkoder.gov.al/">https://bashkiashkoder.gov.al/</a></p> <p><b>Aplikimi online:</b></p> <p>Shërbimi elektronik “<i>Kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social</i>” i mundëson qytetarëve të aplikojnë online për të përfituar nga programet e strehimit social, për strehim dhe banesa sociale. Shërbimi ofrohet në përputhje me bazën ligjore.<sup>1</sup></p> <p><b>Hapat e procedurës</b></p>
---	---

<sup>1</sup> Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.06.2019 për “Përcaktimin e dokumentacionit, për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 01.06.2016 për “Miratimin e strategjisë së strehimit social 2016 – 2025”;

	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Identifikohuni si “qytetar” në portalin <i>e-Albania</i> pranë faqes <a href="http://www.e-Albania.al">www.e-Albania.al</a></li> <li>○ Përzgjidhni shërbimin “Kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social”;</li> <li>○ Klikoni butonin “Përdor”;</li> <li>○ Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi të dhënat e aplikimit, përfaqësuesit, kushtet e strehimit, kushtet familjare dhe sociale;</li> <li>○ Përzgjidhni programin e strehimit të preferuar dhe ngarkoni dokumentacionin e kërkuar;</li> <li>○ Klikoni butonin "Apliko" për të përfunduar aplikimin.</li> </ul>
<p><b>2. Përfitimi nga programet e mbështetjes për marrjen e ndihmës ekonomike?</b></p>	<p>Përmes paketës së plotë të ndihmës, subvencioneve shtesë për fëmijët që ndjekin arsimin e detyruar, fëmijët që vaksinohen dhe kompensimit për energjinë elektrike, programi i ndihmës ekonomike siguron mbështetje për kategoritë në nevojë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, si dhe kategorive të tjera sociale si: viktimat e trafikimit, dhunës në familje, individët me statusin e jetimit që nuk jetojnë në institucionet e përkujdesjes, fëmijët në kujdestari të familjeve kujdestare, si dhe prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh.</p> <p><b>Hapat e procedurës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Identifikohuni si “qytetar” në portalin <i>e-Albania</i> pranë faqes <a href="http://www.e-Albania.al">www.e-Albania.al</a></li> <li>○ Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania</li> <li>○ Zgjidhni shërbimin "Ndihma ekonomike për individë"</li> <li>○ Klikoni butonin "Përdor"</li> <li>○ Konsultoni online informacionin në lidhje me ndihmën ekonomike</li> </ul> <p>Ju gjithashtu mund të merrni informacion mbi rregullat e aplikimit për ndihmën ekonomike pranë seksioneve të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore në bashkinë/njësinë administrative të territorit ku banoni, dhe aplikoni nga data 1- 10 e çdo muaji, duke u paraqitur me kartën e identitetit.</p>



<p><b>3. Aplikimi për kartë shëndeti</b></p>	<p>Ju mund të aplikoni për kartë shëndeti online në portalin <i>e-Albania</i> pranë faqes <a href="http://www.e-Albania.al">www.e-Albania.al</a></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Identifikohuni si “qytetar” në portalin e-Albania;</li> <li>○ Pasi logoheni , në kategorinë e-shërbime përzgjidhni shërbimin “Aplikim për Kartë Shëndeti”</li> <li>○ Klikoni butonin “Përdor”</li> <li>○ Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi të dhënat e aplikimit, përfaqësuesit, kushtet e strehimit, kushtet familjare dhe sociale;</li> <li>○ Përzgjidhni programin e strehimit të preferuar dhe ngarkoni dokumentacionin e kërkuar;</li> <li>○ Klikoni butonin "Apliko" për të përfunduar aplikimin.</li> </ul> <p><b><i>Kujdes!</i></b> Në rast se nuk jeni i regjistruar në regjistrin elektronik të mjekut tuaj të familjes, nuk mund të përfitoni kartën e shëndetit.</p> <p>Nëse pajiseni me kartë shëndeti për herë të parë duhet të paraqiteni pranë mjekut tuaj të familjes për të konfirmuar regjistrimin në regjistrin elektronik të tij. Mjeku juaj u familjes do të verifikojë me kujdes në regjistrin elektronik të tij, saktësinë e të dhënave të personave dhe do të përditësojë informacionin në dosjen tuaj.</p> <p>Dokumentet që duhet të paraqiten pranë qendrës shëndetësore, pasi është kryer aplikimi online për Kartë Shëndeti:</p> <p>Dokumentacion i identifikues:</p> <p><b>a.</b> Për shtetasit shqiptarë: Kartën e Identitetit; për fëmijët deri në moshën 16 vjeç, në mungesë të Kartës së Identitetit, paraqitet certifikata e gjendjes civile ose pasaporta, te cilat janë dokumente që përmbajnë numrin personal të identitetit.</p> <p><b>b.</b> Për shtetasit e huaj: Leja e qëndrimit ose leja provizore e qëndrimit e lëshuar nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin.</p> <p>Për informacion më të detajuar ju lutem vizitoni: <a href="#">Dokumentacionin që vërteton kategorinë përfituese dhe afatin e përfitimit.</a></p>
--	--



<p><b>4. Programet e nxitjes së Punësimit për Punëkërkuessit</b></p>	<p>Ju mund të përfitoni nga programet e nxitjes së punësimit për grupin e veçantë të punëkërkuessve të papunë pranë Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.</p> <p>AKPA funksionon nëpërmjet Zyrave Rajonale dhe Vendore të Punësimit, si dhe Drejtorive të punësimit Shkodër. Shërbimet që ofron Agjencia Kombëtare E Punësimit dhe Aftësive janë shërbime publike që ofrohen nga Zyrat e Punësimit në të gjithë Republikën e Shqipërisë si për:<sup>2</sup></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• punëkërkuessit dhe</li> <li>• për punëdhënësit.</li> </ul> <p><b>Shërbimet e Punësimit përfshijnë veprimtaritë e mëposhtme:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a) Informim për vendet e lira të punës;</li> <li>b) Ndërmjetësim për punësim;</li> <li>c) Këshillim dhe orientim për punë dhe profesion.</li> </ol> <p>Regjistrohuni në Zyrat Vendore të Punësimit në linkun: <a href="http://akpa.gov.al/drejtorite-rajonale-zyrat-vendore-te-punesimit/">http://akpa.gov.al/drejtorite-rajonale-zyrat-vendore-te-punesimit/</a> për të përfituar nga programet e punësimit për të rinjtë, të kthyerit nga emigracioni, të sapo diplomuarit, personat nga grupet në nevojë etj.</p> <p><b>Hapat e procedurës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania pranë faqes <a href="http://www.e-Albania.al">www.e-Albania.al</a></li> <li>○ Zgjidhni shërbimin "Aplikim për regjistrim si punëkërkuess";</li> <li>○ Klikoni butonin "Përdor";</li> <li>○ Aplikanti plotëson të dhënat e tjera dhe dërgon formularin;</li> <li>○ Zyra e Punës njoftohet për ardhjen e aplikimit dhe e shqyrton atë;</li> <li>○ Zyra e Punës njofton aplikantin nëse aplikimi është pranuar apo refuzuar (së bashku me arsyetimin përkatës). Në rastin kur aplikimi është pranuar, Zyra e Punës i cakton një datë dhe orë aplikantit për takimin pranë kësaj zyre pune.</li> <li>○ Aplikanti duhet të paraqitet në takim si dhe të përmbushë</li> </ul>
--	---

<sup>2</sup> Shërbimet e punësimit ofrohen në bazë të Ligjit Nr. 7995 datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", i ndryshuar me ligjin nr. 8444 21.1.1999, ndryshuar me ligjin nr. 8862 datë 7.3.2002, si dhe me ligjin nr 9570 date 3.7.2006, specifikisht sipas nenit 6 dhe 6/1 , nenit 7 dhe 7/1

	<p>kriteret e përcaktuara sipas ligjit për regjistrimin si punëkërkuar i papunë.</p>
<p><b>5. Njohuritë profesionale</b></p>	<p>Në rast se keni nevojë të fitoni njohuri të reja profesionale ju mund t'i drejtoheni Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik, kjo drejtori është institucion në varësi të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Sistemi i arsimit dhe formimit profesional publik përbëhet nga 41 institucione nga të cilat 31 shkolla profesionale dhe 10 qendra formimi të cilat ofrojnë kualifikime profesionale të mesme pas të mesme dhe afatshkurtra, për të gjitha moshat. Nëse jeni një emigrant i kthyer do të keni akses në klasat e përshtatshme të gjuhës dhe mundësi të tjera trajnimi dhe arsimimi për tu pajisur që të hyni në tregun e punës.</p> <p>Janë aktualisht rreth 106 Kurse Profesionale të ofruara nga Qendrat e Formimit Profesional.</p> <p>Për informacion më të detajuar ju lutem vizitoni: <a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12549">https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12549</a></p> <p><b>Hapat e procedurës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Identifikohuni si qytetar në portalin <i>e-Albania</i> pranë faqes <a href="http://www.e-Albania.al">www.e-Albania.al</a> ;</li> <li>○ Zgjidhni shërbimin “Aplikim për regjistrim në kurs formimi profesional”</li> <li>○ Klikoni butonin “Përdor”;</li> <li>○ Aplikanti plotëson të gjithë të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular dhe ngarkon dokumentacionin e kërkuar;</li> <li>○ Klikoni butonin “Dërgo”;</li> <li>○ Nëse jeni i regjistruar si punëkërkuar i papunë pranë Zyrës së Punës, kursin Profesional e përfitoni falas (përveç kurse të gjuhëve të huaja)</li> <li>○ Qendra e Formimit Profesional Publik njoftohet për ardhjen e aplikimit dhe shqyrton atë;</li> <li>○ Qendra e Formimit Profesional Publik njofton aplikantin nepërmjet një mesazhi tek Mesazhet e mia, nëse aplikimi është pranuar apo refuzuar, së bashku me arsyetimin përkatës.</li> </ul>



## 6. Regjistrimi i fëmijës në gjendjen civile

Ju mund të aplikoni për regjistrimin e fëmijës tuaj online në portalin *e-Albania* pranë faqes [www.e-Albania.al](http://www.e-Albania.al)

- Identifikohuni si “qytetar” në portalin e-Albania;
- Pasi logoheni , në kategorinë e-shërbime përzgjidhni shërbimin “Aplikim për regjistrim fëmije”
- Klikoni butonin “Përdor”
- Plotësoni të dhënat personale në formularin elektronik dhe ngarkoni dokumentet që janë të domosdoshme për asistencën që kërkohet. Me anë të e-mail-it të plotësuar në rubrikën përkatëse, do t'ju dërgohet konfirmimi i aplikimit si dhe kodi i veçantë i aplikimit (i cili mundëson ndjekjen e ecurisë së aplikimit në çdo moment)
- Dorëzoni me postë ose personalisht, dokumentin e lindjes së fëmijës.
- Pas verifikimeve të nevojshme të kryera nga përfaqësues të Ambasadës/Konsullatës, do të njoftoheni me anë të e-mail-it apo nëpërmjet numrit të telefonit (rast urgjent)

### Udhëzime:

Dokumentet e lëshuara nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë, duhet të kenë vulën ‘Apostile’ ose do të jenë të legalizuara në përfaqësitë konsullore të Shqipërisë. Nëse përkthimi i aktit apo certifikatës së lindjes është bërë nga një përkthyes i huaj, ju duhet të aplikoni për Vërtetim Përkthimi në Ambasadë/Konsullatë në link:

<https://punetejashtme.gov.al/aplikim-per-perkthim-dokumenti/>

Dokumentacioni origjinal së bashku me pagesën e tarifës së Vërtetimit të Përkthimit dërgohen me postë në adresën e Ambasadës/Konsullatës ose dorëzohen dorazi përgjatë orarit zyrtar.

“I rëndësishëm është “ **Deklarimi i adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**” ju mundëson shtetasve shqiptarë të cilët janë me vendbanim të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të kryejnë vetëdeklarimin e adresës së banimit me të dhënat e sakta në shtetin ku ata jetojnë. Formulari i vetëdeklarimit elektronik mund të plotësohet nga shtetasit për deklarimin e

	<p>adresës së tyre personale, ose dhe për anëtarët e të njëjtës familje, në rastin kur ata jetojnë në të njëjtin vendbanim me deklaruesin.</p> <p>Link i aplikimit: <a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12575">https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12575</a></p> <p>Është detyrë e vet prindërve që të interesohen për kryerjen e të gjitha procedurave që bëjnë legalisht të vlefshëm aktin e lindjes së fëmijës, për ta regjistruar atë në zyrat e gjendjes civile në Shqipëri.</p> <p>Ju mund të gjeni informacion më të detajuar mbi fazat e procedurës së aplikimit pranë faqes së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme <a href="https://punetejashtme.gov.al/aplikim-per-regjistrim-femije/">https://punetejashtme.gov.al/aplikim-per-regjistrim-femije/</a></p>
<p><b>7. Regjistrimi i fëmijës në shkollë</b></p>	<p>Bazuar tek udhëzuesi specifik i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), të kthyerit e moshës shkollore trajtohen me përparësi dhe ndihmohen për përfshirje në sistemin arsimor.</p> <p>Masa të veçanta ndërmerren edhe për rregjistrimin në kopshte. Arsimi parashkollor është në varësi të Bashkisë, e cila është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së shërbimit arsimor parashkollor në territorin e saj. Arsimi parashkollor frekuentohet nga fëmijë të moshës 3 – 6 vjeç, dhe nuk është i detyruar.</p> <p>Arsimi bazë i detyruar fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi është i detyruar të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç.</p> <p>Arsimi i mesëm dhe i lartë nuk është i detyrueshëm dhe përbëhet nga gjimnazet me kohë të plotë dhe të shkurtuar, shkollat social-kulturore dhe profesionale. Arsimi i mesëm me kohë të plotë zgjat 3 vjet, ndërsa arsimi i mesëm i ulët ose me kohë të shkurtuar zgjat 4 vjet.</p> <p>Zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) bëjnë unifikimin e dokumenteve shkollore që sjellin me vete dhe i regjistrojnë ata në shkolle. Kur është e nevojshme, ata gjithashtu mbështeten nga një program individual për gjuhën shqipe dhe për lëndët e veçanta. Prindërit apo kujdestarët ligjorë, të nxënësit që rikthehet në Shqipëri nga emigracioni dhe duhet të regjistrohet në institucionet arsimore parauniversitare, fillimisht duhet të aplikojnë në portalin <i>e-Albania</i> për “<i>Aplikim për njëvlefshmërinë e dëftesave të</i></p>



	<p><i>nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”.</i></p> <p><b>Hapat e procedurës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania <a href="http://www.e-Albania.al">www.e-Albania.al</a></li> <li>○ Zgjidhni shërbimin “<i>Aplikim për njëvlefishmërinë e dëftesave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit</i>”;</li> <li>○ Klikoni butonin "Përdor";</li> <li>○ Prindi dhe /ose kujdestari ligjor plotëson të gjithë të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular dhe ngarkon dokumentacionin e kërkuar;</li> <li>○ Klikoni butonin "Dërgo";</li> <li>○ Personi përgjegjës në ZVAP, kryen njehsimin e dëftesës së klasës sipas përcaktimeve të udhëzimit të MASR . ZVAP njofton zyrtarisht drejtorin e shkollës për klasën ku nxënësi do të regjistrohet dhe për vlerësimet e konvertuara.</li> <li>○ Dokumenti i vulosur dërgohet në seksionin "Dokumentet e mia" te hapësira juaj në portalin e-Albania.</li> </ul>
<p><b>8.Shërbimi psikosocial për fëmijët në shkolla</b></p>	<p>Bazuar në aktin “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psikosocial”<sup>3</sup> Shërbimi psikosocial (SHPS) ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psikosociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor.</p> <p>Shtrirja e këtij shërbimi është si në zonat urbane, po ashtu edhe në zonat rurale, për të gjithë fëmijët e moshës nga 0 deri 18 vjeç.</p> <p>SHPS-ja vlerëson gjendjen psikosociale të nxënësve me probleme të të nxëniet ose të sjelljes dhe në bashkëpunim me mësues e</p>

<sup>3</sup> Për Organizimin Dhe Funksionimin E Shërbimit Psikosocial Nëinstitucionet E Arsimit Parauniversitar Dhe Procedurat Eemërimit, Pezullimit Dhe Largimit Në Shërbimin Psikosocial (ndryshuar me urdhrin nr. 358, datë 23.12.2020; nr. 414, datë 26.7.2023) <https://qbz.gov.al/preview/060fa348-d094-4681-82be-be153e394460/cons/20230808>

	<p>drejtues të institucioneve arsimore dhe prindërit, planifikon dhe realizon shërbime që ndihmojnë në zhvillimin arsimor, social dhe personal të nxënësve.</p> <p>SHPS-ja u ofrohet nxënësve të institucioneve publike të arsimit parauniversitar dhe sigurohet nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në institucionet private të arsimit parauniversitar, ky shërbim ofrohet nga vetë institucioni.</p>
<p><b>9. Ndhimja personale</b></p>	<p><b>10. Kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal<sup>4</sup></b></p> <p>Në rast se jeni një person me aftësi të kufizuara dhe ( fëmijë apo person mbi moshën 18 vjeç ju mund të përfitoni shërbime nga një ndihmës personal.</p> <p>Ndihmësi personal është ai individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara, për ta ndihmuar këtë të fundit që të kapërcejë pengesat në jetën e përditshme.</p> <p>2. E drejta e përfitimit të ndihmësit personal përcaktohet, nga:</p> <p>a) komisionet mjekësore për caktimin e aftësisë për punë;  b) Komisioni Mjekësori i Përcaktimit të Verbërisë;  c) komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar.</p> <p>3. Ndihmësi personal ofron ndihmesën/asistencën personale në cilësinë e ndihmësit, për:</p> <p>a) kujdesin personal për personat me aftësi të kufizuara;  b) shoqëruesit për personat e verbër;  c) interpretuesit e gjuhës së shenjave; dhe  ç) lehtësuesit në komunikim për personat me aftësi të kufizuara, në të folur dhe në të dëgjuar.</p> <p>4. Kriteret që duhet të plotësojnë ndihmësit personal janë:</p> <p>a) të jetë në moshë madhore, mbi 18 vjeç;</p>

<sup>4</sup> VENDIM Nr. 874, datë 24.12.2019. Për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/12/24/874/020e6570-846d-4bbd-b2de-9e74b76c3a84>

	<p>b) të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë, të formës së prerë, për kryerjen e një veprë penale, kundërvajtjeje penale me dashje apo me vendim gjykatë për dhunë në marrëdhëniet familjare;</p> <p>c) të jetë i aftë për t'i shërbyer personit me aftësi të kufizuara;</p> <p>ç) të ketë njohuritë bazë mbi aftësinë e kufizuar, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si edhe mbi etikën në ofrimin e ndihmës/asistencës shtëpiake, sjellje e komunikim ose të jetë i gatshëm t'i përfitojë këto njohuri në një kohë sa më të shpejtë, me qëllim që të garantojë cilësinë e shërbimit të ofruar;</p> <p>d) të ketë marrë udhëzime përgatitore nga përfituesi për të ofruar shërbimet e ndihmës personal; dh) të shprehë gatishmëri për të marrë trajnime të tjera, sipas nevojës.</p> <p>Ndihmësi personal ndihmon personin me aftësi të kufizuara edhe në shoqërimin jashtë shtëpisë për të siguruar pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fetare; shoqërimin për marrjen e shërbimeve sociale, shëndetësore, rehabilituese e integruese dhe shoqërimi për në shkollë për fëmijët e moshës shkollore; marrjen në kohë të mjekimeve, sipas rekomandimit të mjekut etj.</p>
<p><b>Biznesi, Start-Up dhe Vetëpunësimi</b></p>	
<p><b>10. Përegjistrimin e një biznesi</b></p>	<p>Regjistrimi fillestar dhe licencimi i biznesit, ofrohet në mënyrë elektronike, nëpërmjet sportelit elektronik në portalin e-Albania, në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, ligjin për licencimin e biznesit, ligjin për nënshkrimin elektronik dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre”.</p> <p>Ju mund të aplikoni për hapjen e një biznesi online në portalin <i>e-Albania</i> pranë faqes <a href="http://www.e-Albania.al">www.e-Albania.al</a></p> <p>Për të kryer aplikimin për regjistrim fillestar, individit aplikon duke plotësuar formularin përkatës për regjistrim fillestar në varësi të formës ligjore që do të regjistrojë si dhe të paraqesë dokumentet shoqëruese:</p> <p><b>Hapat e procedurës</b></p>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania;</li> <li>○ Zgjidhni shërbimin “Aplikim për regjistrimin fillestar të personit fizik”</li> <li>○ Klikoni butonin “Përdor”</li> <li>○ Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi formën e shoqërisë të cilën do të regjistroni (subjektin) dhe ngarkoni dokumentacionin e nevojshëm</li> <li>○ Klikoni butonin “Dërgo” në faqen e fundit të formularit</li> <li>○ Klikoni butonin “ Dërgo kodin e nënshkrimit”; - Vendos kodin e nënshkrimit dhe kliko butonin “Nënshkruaj”</li> <li>○ Shqyrtimi i aplikimit bëhet nga nëpunësi i autorizuar i QKB-së; - Pas vlerësimit të aplikimit merret vendimi nga nëpunësi i autorizuar ( Pezullim/Miratim/ Refuzim); - Përgjigja dërgohet tek subjekti aplikues, me email, në mënyrë automatike nga sistemi dhe po ashtu tek ”Hapësira Ime” në portalin e-Albania.</li> </ul> <p>Më shumë informacion mbi mënyrën e plotësimit të aplikimit, do ta gjeni në faqen e internetit të QKB-së <a href="http://www.qkb.gov.al">www.qkb.gov.al</a>, në rubrikën “Regjistrimi”.</p> <p><b>Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)</b> është një institucion i themeluar në vitin 2015, bazuar në Ligjin Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit. QKB është institucion në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.dhe ka si qëllim ofrimin e shërbimeve për regjistrimin, licencimin e bizneseve, si dhe regjistrimin e pronarëve përfitues.</p> <p>Ju mund t’i referoheni edhe institucioneve të promovimit të biznesit siç është Dhoma a Tregtisë, si edhe bankave, për t’u interesuar mbi mundësitë e e investimit në Shqipëri, promovimit, rrjetëzimit dhe zgjerimit të partneriteteve, granteve dhe kredive me interes të ulët në mbështetje të biznesit të ri dhe start- up.</p>
<p><b>11. Programi për vetëpunësimin</b></p>	<p><b>Aplikimi për programin e vetëpunësimit</b></p> <p>Shërbimi “Kërkesë për pjesëmarrje në Programin e Vetëpunësimit” mundëson punëkërkesve të papunë që</p>



	<p>kanë një ide biznesi të konkurojnë për idenë e tyre. Programi subvencion për të gjithë të përzgjedhurit sipas një procesi të drejtë dhe konkurues grantin për ngritjen e biznesit deri në masën 1.000.000 (një milion) lekë. Për të aplikuar në këtë program, aplikuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme: · Të jetë punëkërkuar i papunë i regjistruar në strukturën vendore të punësimit; · Të ketë një ide biznesi. <i>Baza ligjore:</i> Ky shërbim mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 348, datë 29.04.2020 për “Procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit, nëpërmjet vetëpunësimit”, i ndryshuar.</p> <p><b>Hapat e procedurës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Identifikohu si qytetar në portalin e-Albania;</li> <li>○ Zgjidhni shërbimin “Kërkesë për Pjesëmarrje në Programin e Vetëpunësimit”; -</li> <li>○ Klikoni butonin "Përdor" dhe plotësoni të dhënat në formular;</li> <li>○ Dërgoni aplikimin duke shtypur butonin “Dërgo”;</li> <li>○ Pas dërgimit me sukses, aplikimi merret në shqyrtim nga personat përgjegjës pranë zyrës së punës. Në rast miratimi, aplikanti njoftohet elektronikisht në adresën e-mail të plotësuar gjatë aplikimit, si dhe në rubrikën “Mesazhet e mia” për procedurat e mëtejshme. Në rast mosmiratimi dërgohet njoftimi i refuzimit, ku shpjegohen dhe arsyet përkatëse.</li> </ul> <p>Për më shumë informacion ju lutem vizitoni: <a href="https://ealbania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=16366">https://ealbania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=16366</a></p>
<p><b>12. Mbështetje me grante për Start-Up.</b></p>	<p><b>Aplikim për mbështetje me grante të StartUp-eve</b></p> <p>Nëpërmjet shërbimit “Aplikim për mbështetje me grante të StartUp-eve” qytetarët dhe subjektet të cilët janë pjesë e një kompanie StartUp mund të aplikojnë për masë mbështetëse me grante. Objektivi i programit Grante2025 është të stimulojë</p>



sipërmarrjen dhe krijimin inovativ të kompanive të bazuara në dije, nëpërmjet bizneseve startup të sektorit privat duke ofruar financim për projekte të orientuara nga tregu me potencial të lartë komercializimi dhe një model biznesi të shkallëzuar.

#### **Hapat e procedures**

- Identifikohuni si qytetar ose si biznes në portal;
- Zgjidhni shërbimin "Aplikim për mbështetje me grante të StartUp-eve";
- Klikoni butonin " Përdor";
- Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme dhe ngarkoni dokumentet e kërkuara në formular;
- Klikoni butonin "Dërgo" në fund të formularit;
- Njësia përgjegjëse pranë Ministrisë të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit merr në shqyrtim aplikimin;
- Përgjigja rreth aplikimit tuaj do ju dërgohet në rubrikën "Dokumentet e mia", si dhe në adresën tuaj e-mail.

Për më shumë informacion ju lutem vizitoni:

<https://startupalbania.al/regional-start-up-ecosystem-development/#>